



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORE
ZYRA E PROTOKOLL-ARKIVES
Nr 1300/4 Prot
Datë 31.10.2017

Nr. Prot.

Tiranë, më 20.10.2017

Vendim
Nr. 33, datë 20.10.2017

PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS SË DREJTUESVE TË QENDRAVE KËRKIMORE-SHKENCORE DHE PËRGJEGJËSIT TË QENDRËS TË FORMIMIT PROFESIONAL NË UNIVERISTETIN "ISMAIL QEMALI", VLORE

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 268, datë 29.03.2017 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 748, datë 11.06.2009 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë" të ndryshuar, vendimin nr. 329, datë 12.04.2017 të Këshillit të Ministrave, pika 17 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik", nenin 25, 26, 45/2, 49 të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe referuar vendimit nr. 65, datë 16.06.2016 të Senatit Akademik "Për emërimin e drejtuesve të qendrave kërkimore-shkencore të fakulteteve", vendimit nr. 5, datë 03.07.2017 të Dekanit të Fakultetit të Ekonomisë "Për emërimin e drejtuesit të qendrës kërkimore-shkencore pranë Fakultetit të Ekonomisë", vendimit nr. 4, datë 15.04.2017 të dekanit të Fakultetit të Shkencave Teknike "Për emërimin e drejtuesit të qendrës kërkimore-shkencore", vendimit nr. 25, datë 21.06.2017 të Dekanit të Fakultetit të Shkencave Humane dhe në dokumentacionin relatives paraqitur nga Administratori i Univeristetit "Ismael Qemali", Vlorë, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 20.10.2017

VENDOSI:

1. Të miratojë pagën e drejtuesve të Qendrave Kërkimore-Shkencore dhe përgjegjësit të Qendrës të Formimit Profesional në Universitetin "Ismael Qemali", Vlorë sipas lidhjes nr. 1 të vendimit nr. 268, datë 29.03.2017, të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në vendimin nr. 748, datë 11.06.2009 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë të ndryshuar"
2. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë nga dita e emërimit të tyre dhe përballohen nga buxheti i Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë.

Adresa /Adress: Bulevardi Vlorë-Skele
Tel. Fax ++355222288

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

Faqe 1 nga 2

OLSI VANGJEU



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

3. Ngarkohet Administratori i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit si dhe Përgjegjësi i Sektorit të administrimit të Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

1. Rezana Vrapit – Kryetar
2. Florian Nurçe – anëtar
3. Enida Pulaj – anëtar
4. Eduard Ahmeti – anëtar
5. Elsajed Rexhaj – anëtar
6. Marinela Muço – anëtar
7. Ornela Koleka - anëtar

[Handwritten signatures in blue ink corresponding to the list members, including names like 'Florian Nurçe', 'Eduard Ahmeti', and 'Elsajed Rexhaj'. There is also a date '17' and a signature 'Pulaj' visible.]

Ky dokument përpilohet në 3 (tre) kopje.